



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:205054

Datë: 23.04.2024

Numri i dokumentit: 05608436

KPPP.nr. 681/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përbarimore të kreditorit “SLS Consulting” SH.P.K., me numër unik identifikues 810192360 dhe seli në Mitrovicë, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit U.G., avokat nga Mitrovica, kundër debitorit “Royal” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810809733 dhe seli në Prishtinë, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Sh.A., avokate nga Prishtina, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar ndaj Urdhrit Përbarimor P.nr. 157/2021, i lejuar me datë 29.06.2021, nga Përbaruesi Privat Ilmi Miftaraj me seli të zyrës në Mitrovicë,, jashtë seancës, me datë 23.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET prapësimi i debitorit “Royal” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810809733, dhe ANULOHET pjesërisht Urdhri Përbarimor P.nr. 157/2021, i lejuar me datë 29.06.2021, nga Përbaruesi Privat Ilmi Miftaraj, për pjesën e detyrimit në lartësi prej EUR 12,235.21.
- II. Pjesa tjetër e Urdhrit Përbarimor P.nr. 157/21, i lejuar me datë 29.06.2021, nga Përbaruesi Privat Ilmi Miftaraj sa i përket detyrimit në lartësi prej ERU 6,976.29, së bashku me kamatën ligjore prej 8% në këtë pjesë të detyrimit, MBETET NË FUQI
- III. Shpenzimet e procedurës përbarimore i bartë secila palë veç e veç.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, mbi bazën e dokumentit të besueshëm; Faturës nr. SLS 0008/20, e datës 03.12.2020, ka lejuar Urdhrit Përbarimor P.nr. 157/21, të datës 29.06.2021, me të cilin është urdhëruar debitorit që kreditorit t’ia paguaj shumën prej EUR 19,301.50, me kamatë ligjore duke filluar nga dita e mos përmbushjes e deri në pagesën

definitive, si dhe shpenzimet përmbartimore dhe shpenzimet në emër të përpilimit të propozimit për përmbartim në lartësi prej EUR 312.00.

Debitori, brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor, me arsyetim se shuma e kërkuar si në propozim nga ana e kreditorit nuk qëndron si e tillë, ngase debitori i detyrohet kreditorit vetëm shumën prej EUR 6,976.29. Ka shtuar se propozimi për përmbartim nuk e përmban gjendjen reale të faturave, konkretisht faturimin real vjetor ndërmjet palëve kontraktuese, dhe se nuk përputhet me faturën e lëshuar nga kreditori, rrjedhimisht shuma e kërkuar për përmbushje nga kreditori është më e lartë se gjendja reale e borxhit.

Poashtu, ka theksuar se sipas nenit 6 të kontratës së nënshkruar mes palëve, kreditorit i takojnë 10% e qirave të kontraktuara për vitin e parë dhe jo 10% e kontratës së nënshkruar me qiramarrësit. Në fund, debitori ka shtuar se për shërbime lidhur me lokalin Fresh Group kreditori nuk është dashur ta faturoj fare këtu debitorin; për shërbimet për lokalin Shoe City, kreditori është dashur t'ia faturoj debitorit vlerën prej EUR 1,324.54; për shërbimet për lokalin Penina kreditori është dashur t'ia faturoj debitorit vlerën prej EUR 541.20; për shërbimet për lokalin Dreamkid Caffè, kreditori është dashur t'ia faturoj debitorit vlerën prej EUR 723.33; për shërbimet për lokalin Libraria kreditori është dashur t'ia faturoj debitorit vlerën prej EUR 677.33; për shërbimet për lokalin Sophie Caffè kreditori është dashur t'ia faturoj debitorit vlerën prej EUR 912.88; për shërbime për lokalin Nuka Home kreditori është dashur t'ia faturoj debitorit vlerën prej EUR 1587.02; për shërbime për lokalin Cash Home kreditori është dashur t'ia faturoj debitorit vlerën prej EUR 849.69; ndërsa për lokalin One Celo nuk është dashur të faturohet debitori ngase i njejtë nuk ekziston si lokal në hapësirat e debitorit. Andaj, për këto arsye debitori i ka propozuar gjykatës që urdhrin mbi lejimin e përmbartimit ta anuloj pjesërisht, ndërsa të mbetet në fuqi vetëm për pjesën e borxhit në lartësi prej EUR 6,976.29.

Kreditori në përgjigje në prapësim i ka kundërshtuar pretendimet e debitorit dhe ka theksuar se fatura mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri i plotëson të gjitha elementet sipas LPP-së, për tu konsideruar si dokumenti i besueshëm, dhe se e njejtë është pranuar nga ana e debitorit. më tej, ka theksuar se palët kanë pasur marrëveshje ndërmjet vete për kryerjen e shërbimeve ku kreditori ka qenë i obliguar që ta menaxhoj dhe mirëmbaj objektin e debitorit. Sipas kësaj kontrate, debitori ka qenë i obliguar që të paguaj shumën prej 10% e të hyrave na qiratë për kreditorin. Ndërsa, ka shtuar se debitori me anë të prapësimin nuk e ka paraqitur gjendjen reale, ngase i ka treguar vetëm faturat të cilat ai i ka dorëzuar qiramarrësve për qira dhe nuk i ka paraqitur faturat për shpenzimet e përbashkëta. Në fund, ka theksuar se urdhri përmbartimor është tërësisht i

bazuar në dispozita të LPP-së, ndërsa gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pabazuar ndërsa urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi. Poashtu, i ka kërkuar shpenzimet në emër të përpilimit të përgjigjes në prapësim.

Gjykata, fillimisht me Aktvendimin KPPP.nr. 692/22, të datës 20.09.2023, në pikën I të dispozitivit ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit dhe ka anuluar pjesërisht urdhrin përmbartimor P.nr. 157/21, të datës 29.06.2021 për pjesë e shpenzimeve në emër të përpilimit të propozimit për përmbartim mbi shumën prej EUR 208.00, ndërsa në pikën II të dispozitivit ka refuzuar pjesërisht prapësimin e debitorit duke lënë në fuqi urdhrin përmbartimor për borxhin kryesor në vlerë prej EUR 19,301.50 si dhe shpenzimet për përpilim të prapësimin në lartësi prej EUR 208.00.

Ndaj këtij aktvendimi, debitori ka paraqitur ankesë, ndërsa gjykata e shkallës së dytë me Aktvendimin K.Dh.Sh.II.nr. 1424/23, të datës 15.03.2024, ka aprovuar ankesën e debitorit, aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë KPPP.nr. 692/22, të datës 20.09.2023 e ka anuluar dhe lëndën e ka kthyer në rivendosje. Në arsyetimin e saj, gjykata e shkallës së dytë ka udhëzuar që në rivendosje të vërtetohet drejtë dokumenti i besueshëm dhe shuma e borxhit e cila mund të vërtetohet mbi faturën në bazë të së cilës është lejuar urdhri përmbartimor, si dhe të merret parasysh edhe pohimi i borxhit nga ana e debitorit deri në vlerën prej EUR 6,976.29.

Në rivendosje, gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të palëve, shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke marr për bazë edhe udhëzimet e gjykatë së shkallës së dytë të dhëna në Aktvendimin K.Dh.Sh.II.nr. 1424/23, të datës 15.03.2024, në mbështetje të dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje: “LPP”) gjeti se prapësimi i debitorit i paraqitur në raport me pjesën e urdhrin përmbartimor për detyrimin në lartësi prej EUR 12,235.21 është i bazuar dhe vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi, për këto arsye:

Sipas nenit 29, paragrafi 1 i LPP-së, “Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”, ndërsa pika 1.3 e të njëjtit nen përcakton faturën si dokument i besueshëm sipas të cilës mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla. Tutje, me paragrafin 3 të të njëjtit nen parashihet se: “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”. Në anë tjetër, sipas nenit 37 të LPP-së: “Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të

besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit".

Në mbështetje të dispozitave të cekura si më lartë, gjykata vendosi si në pikën I të këtij Aktvendimi duke anuluar pjesërisht Urdhri Përmbarimor P.nr. 157/2021, për borxhin në lartësi prej EUR 12,235.21, dhe atë sipas Faturës nr. SLS 0008/20, të datës 03.12.2020, për arsye se e njëjta faturë, në raport me lartësinë e detyrimit të përcaktuar në të, nuk i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm, ngase kreditori nuk ka dëshmuar se debitori është njoftuar dhe pajtuar me lartësinë e detyrimit të përcaktuar në dokument – faturë, pasi që fatura nuk është pranuar nga ana e debitorit. Ndërsa, duke qenë se në këtë fazë të procedurës debitori faturën e kundërshton vetëm në raport me lartësinë e saj mirëpo jo edhe elementet tjera të saj, rezulton se lartësia e detyrimit e përcaktuar në faturës është bërë në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit dhe për pjesën e kontestuar të detyrimit fatura nuk i plotëson kushtet për të qenë e përshtatshme për përmbarim.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi duke lënë në fuqi urdhrin përmbarimor për pjesën e detyrimit prej EUR 6,976.29, ngase këtë pjesë të detyrimit debitori nuk ka paraqitur prapësim dhe nuk e ka kundërshtuar detyrimin ndaj kreditorit, duke pranuar faturën mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri përmbarimor deri në vlerën prej EUR 6,976.29, dhe duke i propozuar gjykatës që urdhri përmbarimor të anulohet në raport me shumën prej EUR 12,235.21, ndërsa të mbetet në fuqi për pjesën e detyrimit prej EUR 6,976.29.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktvendimi duke u mbështetur në nenin 17 të LPP-së, lidhur me nenin 450, dhe 452.2 të Ligjit për procedurën kontestimore.

Nga sa më sipër, bazuar në nenin 73, paragrafi 3 të LPP-së, nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2, dhe Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 681/24, datë 23.04.2024

Gjyqtari

Arbër Rexha

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.